

VENDIM
Nr.1195, datë 3.12.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR PORTO ROMANO – DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Porto Romano -Durrës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 12 723 (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) m², tokë arë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 45 802 800 (dyzet e pesë milionë e tetëqind e dy mijë e tetëqind) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 322 000 (treqind e njëzet e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 45 802 800 (dyzet e pesë milionë e tetëqind e dy mijë e tetëqind) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 3.12.2009 dhe të përfundojë më 28.2. 2010.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet vendimit, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I RRUGES" Porto Romano-Durres "

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadast.	Nr. Pasurise	Siperf. pergjith.	LLOJI I PASURISE						Shuma:	Shenime
							TRUALL			Are				
							M ²	Çmimi	Vl.(Leke)	m2	cmimi	Vl.(lekë)		
1	Kastriot		Dyrmishi	8517	104/14	13338				1915	3600	6894000	6894000	Konf.ZVRPP
2	Olsi		Ceci	8517	104/15	4104				1370	3600	4932000	4932000	Konf.ZVRPP
3	Zyhdi		Lala	8517	104/10	12312				2231	3600	8031600	8031600	Konf.ZVRPP
4	Asllan		Marku	8517	104/9	9234				1716	3600	6177600	6177600	Konf.ZVRPP
5	Zibe		Tola	8517	104/8	4104				836	3600	3009600	3009600	Konf.ZVRPP
6	Aferdita		Hoxha	8517	104/7	4104				807	3600	2905200	2905200	Konf.ZVRPP
7	Ali		Badolli	8517	104/6	4104				744	3600	2678400	2678400	Konf.ZVRPP
8	Shqipe		Bodolli	8517	104/5	4104				760	3600	2736000	2736000	Konf.ZVRPP
9	Florina		Hoxha	8517	104/4	4104				803	3600	2890800	2890800	Konf.ZVRPP
10	Hafizet		Abazi	8517	104/3	4104				811	3600	2919600	2919600	Konf.ZVRPP
11	Ylvi		Isaku	8517	104/2	4104				730	3600	2628000	2628000	Konf.ZVRPP
	Shuma:									12723		45802800	45802800	

